

Permbledhje Joteknike

Institucionet Shëndetësore



Personi Juridik : Spitali Unviersitar Obsetrik Gjinekologjik “Koco Glozheni”

Nipt: K51730009H

Adresa: Rruga “Bulevardi Bajram Curri”, tek Brryli, Tirane

Tabela përmbledhese e permbjedhjes joteknike

1. Profili I operatorit	3
1.1 Proçesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis	3
1.2 Kerkesat per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti	4
2. Përshkrimi i aktivitetit;	5
2.1 Qellimi;	5
2.2 Subjekti investitor;	5
2.3 Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit;	5
2.4 Te dhena teknike te aktivitetit;	6
3. Identifikimi dhe vleresimi I shkarkimeve kryesore ne mjedis;	8
4. Identifikimi dhe vleresimi I ndikimeve ne mjedis te aktivitetit;	9
4.1 Analizimi I ndikimeve te pritshme ne mjedis;	10

1. Profili I operatorit

Personi juridik Spitali Unviersitar Obsetrik Gjinekologjik “Koco Glozheni” do te pajiset me Leje Mjedisi tipi B, sipas legjislacionit aktual ne fuqi, per aktivitetin “**Institucione Spitalore**”, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me Nipt K51730009H dhe vendndodhje te ushtrimit te aktivitetit Rruga “Bulevardi Bajram Curri”, tek Brryli, Tirane.

Qellimi i ketij projekti eshte funksionimi I Qendres Spitalore. Subjekti per zhvillimin e aktivitetit te tij do te disponon:

- Sherbime dhe ambjente teknike me siperfaqe 1196 m²
- Hyrja kryesore, ambjente pranimit, ambjente trajtimi ambulator, laboratore, zyra, izolim prematuranc, izolim obsetrik, rontgen etj si dhe ambjente sherbi me siperfaqe 2103 m².
- Ambjente te reaminacionit te pergjithshem gjinekologjik me siperfaqe 1406 m²
- Ambjente te reaminacionit te lindjes si dhe ambjente ndihmese te tyre me siperfaqe 1230 m²
- Obstrika dhe ambjente ndihmese te saj me siperfaqe 1730 m²
- Reaminaioni I prematurances dhe prematuranca dhe ambjente ndihmese te tyre me siperfaqe 865 m²
- Patologjia e barres dhe ambjetet ndihmese te saj me siperfaqe 865 m²

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shtetore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti “Vathe Manahasa”.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivitete ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.3 Kërkesat Vlerësimin te Ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit ne mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerëimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerëimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerëimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerëimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i funksionimit të këtij aktiviteti është dhënia e ndihmës mjekësore për pacientet për ky spital është i përqendruar në fushën e gjinekologjise dhe obstetrikes, duke marrë parasysh të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, gjithashtu duke minimizuar në mënyrën më të mirë ndikimet në mjedis që mund të lindin nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

Në këtë raport vlerësimi do të vlerësojë vetëm ndikimet e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Glozheni”.

2.2 Subjekti investitor

Personi juridik: Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Glozheni”

2.3 Vendodhja e aktivitetit

Rruga “Bulevardi Bajram Curri”, tek Brryli, Tiranë. Ky aktiviteti zhvillohet në një godinë me sipërfaqe totale ndërtimi 9395 m². Objekti në dispozicion të shërbimit spitalor identifikohet sipas koordinatave të mëposhtme:



Nr	X	Y
1	4402833.05	4578149.52
2	4402847	4578157.2
3	4402846.31	4578145.59
4	4402839.22	4578137.69
5	4402851.39	4578161.08

6	4402877.04	4578175.34
7	4402890.48	4578151.24
8	4402864.55	4578136.56
9	4402878.85	4578175.18
10	4402905.77	4578189.71
11	4402911.07	4578176.21
12	4402887.54	4578163.46
13	4402881.95	4578140
14	4402906.88	4578153.01
15	4402916.15	4578143.11
16	4402887.62	4578128.25

2.4 Te dhena te aktivitetit

Ekzaminimet dhe sherbimet qe kryhen ne Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Koco Glozheni"

- Urgjenca
- Reanimacioni
- Kirurgji
- Pediatri
- Laborator analizash

Reparti i urgjences - Ne kete repart, vendosen perkohesisht pacientet qe vijne ne raste urgjente. Fillimisht ato qendrojne aty per nje kohe te caktuar, per tu zhvendour me pas ne pavionin perkates pas konsultave te mjekeve qe jane te punesuar ne kete strukture. Gjithashtu ne kete pavion kryhen ekzaminimet paraprake. Reparti eshte i pajisur me dhomat ekzaminuese, zyrat e mjekeve dhe dhomat e konsultave. Cdo dhome eshte e pajisur me mjete te ndihmes se shpejte, aparate frymarrjeje O₂, elektrohok etj. Pas evidenditimit te diagnozes plotesohen kartelat klinike mjekesore ditore dhe ne raste me te lehta kur pacientet qendrojne vetem per disa ore plotesohen kartelat infjermiore.

Reparti i reanimacionit- sherben per terapi intensive te pacienteve ne gjendje te rende ne fazat para dhe pas lindjes, apo te ndonje diagnostikimi tjetër. Ne disa raste sherben edhe per paciente post operator. Ne kete repart ka aparatura si : Monitor per monitorimin e pacientit, aparate te respiracionit te drejtuar, mjete jo invasive etj. Orjentimi klinik ne kete repart perfshin:

Protokoll mjekimi ne ndjekje te pacienteve jo te operuar ne varesi te diagnozes

Protokolle kujdesi infermieror

Protokoll per trajtimin e dhimbjes postoperator

Kartelet klinike mjeksore

Flete ndjekje 24-oreshe per pacientin nga infermieri

Pershkrimi i kujdesjeve ne ate teknike, higjenes, dietetike

Kirurgjia- Vizioni i punës sonë është sigurimi i një shërbimi shëndetësor me cilësi të lartë dhe të orientuar tek pacienti. Për këtë jemi në përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar të gjithë elementet e kujdesit shëndetësor duke mundësuar arritjen e rezultateve më të mira dhe rritje të justifikuar të besimit të pacientëve tek ne. Trajtohet kryesisht spektri i kirurgjive gjinokologjike. Një vend të rëndësishëm në këtë volum zë mbulimi i shërbimit të Urgjencës Kirurgjikale në të cilën ekipe mjekësh të dedikuar dhe të afirmuar profesionalisht ofrojnë një shërbim të standardeve më të larta në vlerësimin, diagnostikimin dhe trajtimin e emergjencave dhe urgjencave kirurgjikale.

Pediatria- mbulon një gamë të gjërë shërbimesh si pavijoni pedriatik dhe urgjenca pediatrike : Pavijoni i pediatriisë shërben për femijet të cilët lindin me probleme të ndryshme shëndetësore dhe kanë domosdoshmëri të hospitalizohen. Mjekët e specializuar diagnostikojnë problemet dhe kryejnë procedurat e nevojshme për shërimin e të porsalindurve. Reparti është i pajisur me teknologjinë e fundit të inkubimit dhe me të gjithë pajisjet tjera ndihmëse. Urgjenca Pediatrike është një strukturë filtër që i shërben gjithë shërbimeve të Pediatriisë. Fëmijët vëzhgohen gjatë 24 orëshit dhe më pas në varësi të gjendjes shtrohen ose kthehen në shtëpi me mjekimin përkatës. Pacientët e pediatriisë së përgjithshme janë kryesisht me probleme të gastroenteriteve akute, gjendjeve febrile të zgjatura me natyrë të pazgjidhur, intoksikacioneve si dhe me probleme pulmonare akute etj. Shërbimi ka si synim për të ardhmen implementimin e protokolleve dhe evidencave më të mira mjekësore në aktivitetin e përditshëm profesional.

Laborator analizash- Laboratori përfshin analiza të ndryshme për pacientet e porsalindur, por edhe për pacientet që kanë probleme gjinekologjike. Ky laborator është i specializuar dhe

sherben per pacinetet e hospitalizuara, te urgjences apo edhe per kontrolle periodike gjate shtatzanise dhe post shtatzanise.

3. Identifikimi dhe Vleresimit I shkarkimeve ne mjedis

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

1. **Shkarkime ne ajer-** Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk pritet te kete shkarkime te mundshme ne ajer nga kaldaja apo boljere. Shkarkim te mundshem mund te kemi vetem nga makinat e transportit individual apo urgjencat. Meqenese ky spital ofron nje game te gjere sherbimesh, eshte i pozicionuar ne Kryeqytetin e Shqiperise me nje kapacitet prej 195 shtreter eshte e pritshme qe te kemi nje ndikim te mudshem te shtimit te gazeve nga lendet djegese fosile ne zone pasi shume nga pacientet zgjedhin transportin individual per tu paraqitur ne Spital.
2. **Shkarkime ne uje-** Kjo tipologji shkarkimi vjen si rezultat i larjeve te ambjeteve te reparteve dhe pikat e shkarkimit ne nyjet sanitari. Per sa i perket shkarkimeve ne ujra, repartet do te lahen me detergjente te cilet nuk demtojne sistemin e kanalizimeve te zones. Keto ujra do te dergjen ne rrjet per te kaluar ne kolektorin kryesor me pas.
3. **Shkarkimet ne toke-** Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet nga ky aktivitet do te terhiqen nga subjekti "Pura Medical" sh.p.k per ti asgjesuar me pas sipas legjislacionit aktual ne fuqi.

4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
 Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
 Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
 Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
 Parimi i qasjes së integruar
 Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Parimi “Ndotësi paguan”

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Ndikime ne toke	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Nga sallat kirurgjikale	Mbetjet kirurgjikale duhet te evadohen nga operatore te licencuar.
Nga repartet e urgjences dhe reparte te tjere ne funksion te spitalit	Mbetje si sheringa, mbetje ilacesh, serumesh etj duhet te depozitohen ne kontinieret perkates per tu terhequr me pas nga operatori qe spitali ka kontrate terheqjeje dhe asgjesimi
Preparate nga laboratorit dhe mjete te tjera njeperdorimshe	Kjo tipologji mbetjesh te gjeneruara duhet te depozitohen ne kontinieret e posacem dhe me pas te terhiqen nga subjekti dhe individet e autorizuar.

Ndikime ne uje	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Larja e reparteve mjekesore	Eshte e rendesishme qe mbetje gjate kirurgjive apo ekzaminimeve te tjera te vendosen ne kontinieret e posacem, ne kete menyre do te ruhet edhe kontaminimi apo ndontja e ujrave te rrjetit. Ne momentin e larjes dyshemaja sduhet te kete mbetje te cilat mund te jene kercenuese per mjedisin ujqor prites. Gjithashtu edhe detergjentet e pastrimit do te merren paqesore me mjedisin dhe me permbajtje te larte kimikatesh te rrezikshme.
Nyjet sanitare	Ne nyjet sanitare priten shkarkime normale si cdo aktivitet i tille i kesaj natyre.

Ndikime ne biodiversitet	
OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
I gjithë objekti	Punimet per funksionimin e aktivitetit do te shoqerohen me modifikim të pejsazhit ekzistues. Për të minimizuar këte ndikim,

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

	operatori do te mbjelle fidane ne perimetrin rrethues te jashtem dhe te brendshem, gjithashtu do te krijoje vazhdimisht pamje vizuale te bukura te cilat ndikojne pozitivisht tek njeriu dhe ambjenti.
--	--

Ndikime ne ajer

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Spitali	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: <ul style="list-style-type: none">- zhurma, te cilat do punohet te jene ne paramtra normal dhe mbi te gjitha ne reference te natyres se aktivitetit eshte e ndaluar gjenerimi i zhurmave te larta pasi prishin qetesine e pacienteve.- pluhur mund te konsiderohet nje ndikim i mundshem, por gjithesesi infrastruktura eshte shume e mire gje qe minimizon kete ndikim.- gaze nga djegia e karburantit mund te jene ne gjenerime me te larta sepse pervec popullimit te zones urbane kemi nje shtim te mjeteve pasi spitali sherben dhe eshte i hapur per te gjithë Republikën e Shqiperise qe do te kene nevojë per trajtime me te specializuara.